



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0533

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) RISAMONT SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të Kuvendi Komunal - Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “ZHVENDOSJA E RRJETIT DHE TRAFOS NË SHESHIN QENDROR” me numër të prokurimit 623-23-5687-5-2-1, me 04/10/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE RISAMONT SH.P.K. me nr. 2023/0533, e datës 31/07/2023, kurse vendimi i AK KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË lidhur me aktivitetin e prokurimit “ZHVENDOSJA E RRJETIT DHE TRAFOS NË SHESHIN QENDROR” me numër të prokurimit 623-23-5687-5-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimit të ankesës, me ç’rast Ankuesit duhet të paraqasë kërkesë për kthimin e mjeteve brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP;

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale –

Kuvendi Komunal - Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 05.06.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit “ZHVENDOSJA E RRJETIT DHE TRAFOS NË SHESHIN QENDROR” me numër të prokurimit 623-23-5687-5-2-1.

Ndërsa me datë 19.07.2023 AK - Kuvendi Komunal - Rahovec ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin njoftim shpërblen me kontratë “FAMIS CO-HC” SH.A.

Me datën 21.07.2023 OE RISAMONT SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK - Kuvendi Komunal - Rahovec. Dhe me datën 21.07.2023 AK – Kuvendi Komunal - Rahovec ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Operatori ekonomik ankues i pakënaqur me Vendimin e AK-së, me datë 31.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër protokolli 533/23.

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës - punë, vlera e parashikuar e kontratës 83,162.50€.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtoj ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me datë 07.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- të aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik
- të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër është pranuar nga gjitha palët. AK nuk është deklaruar rreth rekomandimit të ekspertit, ndërsa Operatori ekonomik pajtohet me rekomandimin e ekspertit.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “RISAMONT” SH.P.K.

Sqarim hyrës - Fillimisht sqarojmë se OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 21.07.2023 me pretendime të njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë. AK me datë 21.07.2023 ka njoftuar përmes email-it OE ankues se Kërkesa për Rishqyrtim nuk ka bazë ligjore

në këtë fazë, rrjedhimisht i ka shqyrtuar pretendimet ankimore. Eksperti Shqyrtues trajton pretendimet që lidhen me veprimet e AK-së në raport me dispozitat e LPP-së, duke mos u lëshuar kështu në trajtimin dhe sqarimin e pretendimeve për shkeljen e dispozitave si dhe rrethanat faktike që supozohet kenë ndodhur jashtë fushëveprimit të dispozitave të LPP-së.

Pra me datën: 31.07.2023, OE “RISAMONT SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0533, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku NUK është rekomanduar për kontratë OE “RISAMONT SH.P.K.”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “ZHVENDOSJA E RRJETIT DHE TRAFOS NË SHESHIN QENDROR” me nr. të prokurimit: "623-23-5687-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 83.162,50 €.

1. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

1. Njoftimi për Kontratë: 05.06.2023
2. Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 16.06.2023
3. Njoftim mbi vendimin e AK-së: 19.07.2023
4. Kërkesa për rishqyrtim dt. 21.07.2023
5. Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt:21.07.2023

2. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- Neni 1 i LPP-së
- Neni 6 i LPP-së
- Neni 7 i LPP-së
- Neni 56 i LPP-së
- Neni 59 i LPP-së
- Neni 61 i LPP-së
- Neni 66 i LPP-së
- Neni 69 i LPP-së
- Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
- Neni 11 i Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurim Publik

Përgjigjet në Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP nga OE “RISAMONT SH.P.K.”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “ZHVENDOSJA E RRJETIT DHE TRAFOS NË SHESHIN QENDROR” me nr. të prokurimit: "623-23-5687-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË

Duke qene se OE ankues përveç qe ka pretendime ne OE te rekomanduar për kontratë në procedurën e fundit, gjithashtu ka pretendime edhe për OE te eliminuar i cili në fillim te procedurës është rekomanduar për kontratë ndaj përgjigje në pretendime do të japim vetëm për çështjet të cilat lidhen me OE ankues dhe OE të rekomanduar për kontratë.

1 - PRETENDIMI ANKIMOR - Me datën 04.07.2023 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë ERPOWER & VOLTECH Neve kemi kërkuar qasje në dokumente dhe të njëjtën e kemi realizuar me datë 07.07.2023. Me datë 10.07.2023 kemi dorëzuar kërkesën e parë për rishqyrtim, pas së cilës AK e ka aprovuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka kthyer procesin në Ri-shqyrtim.

Rezultatit e rivlerësimit e kemi pranuar me datën 19.07.2023, ku kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, sipas se cilit OE FAMIS CO është rekomanduar për kontratë.

Në lidhje me arsyet e eliminimit tonë nga ana e AK-së, ju sqarojmë se arsyet e të njëjtës janë të pa bazuara për faktet si në vijim:

Në arsyen e parë të eliminimit tonë, AK-ja e ka cekur si në vijim:

Ky pretendim nuk qëndron, pasi që ne e kemi bashkangjitur në dosje të tenderit aneksin 7 të nënshkruar dhe të vulosur dhe gjithashtu e kemi bashkangjitur listën e kontratave të me të gjitha të dhënat e nevojshme, andaj arsyeja e AK-së është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme. Përderisa ne e kemi bashkangjitur listën e kontratave me të gjitha të dhënat e nevojshme, atëherë kuptohet qartë se ne e kemi përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit.

Gjithashtu ky fakt është dashur të konsiderohet si devijim i vogël konform dispozitave të nenit 59.4 pika (ii), pasi që një gjë e tillë nuk ndikon në substancë dhe nuk përbën ndryshime materiale. Në dispozitën e lartcekur është përcaktuar qartë “4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

1 - PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR - Duke qenë se OE ankues nuk ka plotësuar aneksin 7 por ka bashkangjitur në dosje të tenderit aneksin 7 të nënshkruar dhe të vulosur dhe gjithashtu e ka bashkangjitur listën e kontratave të me të gjitha të dhënat e nevojshme të cilat e plotësojnë me informacion aneksin 7 konsideroj se informacioni është dërguar te AK dhe është dashur të merret si e mirëqene. Përderisa OE ankues ka bashkangjitur listën e kontratave me të gjitha të dhënat e nevojshme ashtu siç kërkohen edhe në aneksin 7, atëherë AK është dashur të e pranojë dhe të vlerësojë se OE ankues ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit.

Në vazhdim gjeni të bashkangjitur Aneksin 7 së bashku me listën e kontratave me të dhëna të nevojshme:

ANEKS 7 Lista e kontratave te realizuara ne 3 vitet e fundit

(Duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit per kontrate)

(Ky Aneks eshte obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe eidenton performimin e tillë)

NR.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit te kontratës	Data e përfundimit te kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-maili i Blerësit	Nurmi i telefonit te Blerësit
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							

(Shto/fshij sipas nevojës)

Bashkëngjit: certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues;

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Ankes dhe nëse vertetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë të Operatoreve Ekonomik.

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____



Lista e projekteve te realizuara te natyres se ngjashme 2019-2020-2021

LISTA E PUNËVE TË NGJASHME TË PËRFUNDUARA, REFERENCA PËR 3 VITET E FUNDIT LIST OF REALIZED (COMPLETED) SIMILAR WORKS, REFERENCES FOR LAST 3 YEARS							
PROJEKTET TË PËRFUNDUARA /COMPLETED PROJECTS	DATE E Fillimit dhe Përfundimit sipas Kontratës /STARTING AND ENDING OF THE PROJECT ACCORDING TO CONTRACT		AUTORITETI KONTRAKTUES /CONTRACTING AUTHORITY	VLERË E KONTRATËS /CONTRACT AMOUNT	VLERË E REALIZUAR /REALISED AMOUNT	KOHËZGJATJA E REALIZIMIT TË PROJEKTIT (MUJ) /DURATION OF THE REALIZATION (MONTHS)	PËRFUNDIMI I KONTRATËS (PO/JO) /TERMINATION OF CONTRACT (YES/NO)
2019							
<u>Numri i Prokurimit: KKKO-19-171-121 – Titulli Furnizim me siguresa TL18 shqyrtu dhe 18 masme</u>	16.07.2019	16.08.2019	KEK	€ 11,416.60	€ 11,416.60	1 MUAJ	PO
<u>Furnizimi montimi dhe lëshimi në punë i transformatorit (630KVA) si dhe linjat e tensionit të mesëm për Gjykatë Themelore dhe Prokurori Themelor në Gjakovë.</u>	3/10/2019	12/12/2019	MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE -MAP-	€ 52,431.00	€ 52,431.00	2 MUAJ	PO
<u>Numri i Prokurimit: K-19-3635-136: Titulli Furnizimi dhe montimi i Transformatorit matës TMT 35kV në kishin matës në Stacionin Pompik në Bivollak</u>	20.06.2019	20.07.2019	Ibër Lepenci	€ 3,953.00	€ 3,953.00	1 MUAJ	PO
<u>Numri i Prokurimit: KKKO-17-341-121 – Titulli Furnizimi me lëshime tabellore dhe material për LP</u>	30/04/2018	30/06/2018	KEK	€ 27,399.60	€ 27,399.60	2 MUAJ	PO
<u>Furnizimi montimi dhe lëshimi në punë i transformatorit (1600KVA) për Guriqenë "Crushed Stone" Kline</u>	1/1/2019	9/7/2019	Guriqenë "CRUSHED STONE" KLINE	€ 40,000.00	€ 40,000.00	2 MUAJ	PO
<u>Furnizimi montimi dhe lëshimi në punë i transformatorit (250KVA) dhe linjat e tensionit të mesëm për Kishën Rexhep Zumei - Bablowc-Obila.</u>	19.01.2019	17.05.2019	Fabrika per prodhime nga betoni DETI COM	€ 24,000.00	€ 24,000.00	4 MUAJ	PO
<u>Numri i Prokurimit: 6119092536 – Titulli Ndërtimi i ndërmarrjes publike në dritë të rrugës</u>	23.09.2019	23.09.2019	KOMUNA E PODULLEVËS	€ 5,436.73	€ 5,436.73	1 MUAJ	PO
<u>Numri i Prokurimit: 701-19-5292-1-2-1 – Titulli Furnizimi dhe ndërtimi i siguresave shqyrtu dhe tabelat elektrike ne kishat e QKUK –si</u>	04.09.2019	04.12.2019	QKUK	€ 54,243.18	€ 54,243.18	3 MUAJ	PO

<u>Numeri i Prokurimit: 655-19-3924-S-2-1, Titulli: Nderimi i ndricimit publik ne magjistraten nga Shetimi deri te dogana, Oran lyashdmi dhe nga dalla e qetesit-Perat</u>	05.09.2019	19.12.2019	KOMUNA E PODULJEVE	€ 144,400.56	€ 144,400.56	2 MUAJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: KOSTT 023/176-19-19-121 – Titulli Furnizim me kable 12/24kV</u>	7/8/2019	12/11/2019	KOSTT	€ 12,390.00	€ 12,390.00	2 MUAJ	PO
<u>Nderimi i Biles 04kV per Bleri Dal Berisha Kastriot</u>	06.05.2019	10.06.2019	Bleri Dal Berisha Privat	€ 4,500.00	€ 4,500.00	1 MUAJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: 614 19 076 136 – Titulli Kqaja në rrjetin elektroenergjetik në Sh.F. „Hasan Prishtina”Raskovll</u>	18.10.2019	09.12.2019	KOMUNA E DIBLICIT	€ 2,160.52	€ 2,160.52	2 MUAJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: 200-19-8109-S-3-6 – nr.bordshim 200/19/023/536 Titulli Djalokimi i tensionit të lartë i cili kalon mbi objektin e Zyres së Punisimit në Kacanik-rishpallje</u>	20/11/2019	21/12/2019	Ministria e punës dhe mirënjehjes sociale	€ 7,664.00	€ 7,664.00	1 MUAJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: 617-2019-003-536– Titulli Zhvendosjen e njësisë dhe pajisjeve tjera energetike në palestren e sportit në Shtëpi</u>	19.11.2019	05.02.2020	KOMUNA E SHITES	€ 2,350.00	€ 2,350.00	3 MUAJ	PO
<u>Automatizimi i matjeve te energjive elektrike dhe sasi të naftës ne ndërtuesat shtetërore ne Prishtine</u> <u>Kontrasti korrekt +30%</u>	11/11/2019	11/11/2022	MINISTRIA E ADMINISTRATES PUBLIKE -MAP-	€ 425,862.00	€ 125,000.00	36 MUAJ	PIESRISHT
<u>Nderimi i trafostacionit 250kVA, 200/10/0.4kV per fabrike e kompanive BL-BL Group LLC</u>	09.03.2019	15.05.2019	BL-BL GROUP LLC Investitor privat	€ 27,700.00	€ 27,700.00	2 MUAJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: 612 19 086 521 – Titulli Vendoja e ndricimit publik në territorin e Komunitit të Fushë Kosovës</u>	23.10.2019	06.05.2020	KOMUNA E FUSHË KOSOVËS	€ 67,647.80	€ 67,647.80	6 MUAJ	PO
<u>GJITHSEJTE TE REALIZURA PER VITIN 2019</u>				€ 614,692.99			
2020							
<u>Titulli: FURNITIM ME SHITJA DRUMB, KOKA DHE LIDHJESE KARBLOVITET</u> <u>Numeri prokurimit: KKKO-20-161-121</u>	4/8/2020	7/8/2020	KEK	€ 33,441.20	€ 33,441.20	45 DITE	YES

<u>Numri i Prokurimit: KOSTT023/126-20-10-121 – Titulli: Furnizim me izolatorë. Meme shkarkues mbishkencorë sipas për tërheqje të meeme dhe me materiale termokuribile.</u>	28/01/2020	24/03/2020	KOSTT	€ 35,500.30	€ 35,500.30	60 working days	YES
<u>Autoshtetësimi i mullerave te energjive elektrike dhe shtetë se natifës ne ndërtuesat vendlindore ne Prokurime Kontraktë korrekte +30%</u>	11/11/2019	11/11/2022	MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE -MAP-	€ 425,862.00	€ 125,000.00	36 MUJAJ	PJESËSHIT
<u>Numri i Prokurimit: KRURGIA-20-24-S-2-1 – Titulli: Ndërtimi i lartëpërçuesit dhe trafos 10kV në konstruksion metaliku në fshatin Botushë</u>	21.02.2020	09.07.2020	Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA - SH.A.	€ 23,220.04	€ 23,220.04	60 working days	60 working days
<u>Furnizimi montimi dhe lëshimi në punë i transformatorit (630KVA) dhe linjat e tensionit të mesëm për fabrikën "KOSOVAPOR-MUJA", Suharekë</u>	19/12/2019	3/2/2020	KOSOVAPOR-MUJA	€ 32,000.00	€ 32,000.00	2 MUJAJ	PO
<u>Furnizimi montimi dhe lëshimi në punë i transformatorit (630KVA) si dhe linjat e tensionit të mesëm për Obelkën bazenoll "Shkëlzen Roka dhe Baftijar Hoti" në Gjakovë.</u>	12/2/2020	26/05/2020	Shkelzen Roka & Baftijar Hoti	€ 40,500.00	€ 40,500.00	2 MUJAJ	PO
<u>Numri i Prokurimit: KOSTT 023/126-20-11-171 – Titulli: "Furnizim me rregullator, SET për rregullim dhe Ventilator"</u>	4/6/2020	19.08.2020	KOSTT	€ 12,832.50	€ 12,832.50	90 working days	90 working days
<u>Numri i Prokurimit: KOSTT 023/126-20-13-121 – Titulli: Furnizimin me ndërtuesit të llojit 110, 35 kV dhe kabllo-Furnizim me ndërtues</u>	4/6/2020	12.03.2021	KOSTT	€ 34,371.98	€ 34,371.98	120 working days	PO
<u>Numri i Prokurimit: KKKO-20-074-121 – Titulli: Furnizim me ndërtuesit me sigures, korrektor energjetik dhe dorëza operative për modul</u>	23/06/2020		KEK	€ 35,388.20	€ 35,388.20	60 working days	60 working days
<u>Numri i Prokurimit: 61520011521 – Titulli Ndërtimi i ndryshimit publik në rrugët e qytetit dhe në fshatrat Peran, Bajcinë, Letanc, Obrançë dhe Surkish-LOT1</u>	17.06.2020	23.10.2020	KOMUNA E PODUJEVËS	€ 93,983.99	€ 93,983.99	60 working days	PO
<u>Numri i Prokurimit: 61520011521 – Titulli Ndërtimi i ndryshimit publik në rrugët e qytetit dhe në fshatrat Peran, Bajcinë, Letanc, Obrançë dhe Surkish-LOT2</u>	23.08.2020	11.11.2020	KOMUNA E PODUJEVËS	€ 30,164.41	€ 30,164.41	60 working days	PO
<u>Numri i Prokurimit: 613 020 047 521 – Titulli Ndërtimi i trojeve me ndërtues publik në Shkup</u>	22.07.2020	04.11.2020	KOMUNA E LIPJANIT	€ 69,452.64	€ 69,452.64	60 working days	PO
<u>Numri i Prokurimit: 613 020 034 521 – Titulli Ndërtimi publik me Medec dhe Vrell te Magures</u>	22.09.2020	20.12.2020	KOMUNA E LIPJANIT	€ 47,767.70	€ 47,767.70	70 working days	PO
<u>Numri i Prokurimit: KOSTT023/126-20-10-136 Titulli Furnizim me materiale për ekzaminim e MBNS-çbenderin</u>	24.07.2020	04.08.2020	KOSTT	€ 3,811.40	€ 3,811.40	1 MUJAJ	PO
<u>Numri i Prokurimit: 613 20 048 521 – Titulli Vendeja e ndërtimit publik në rrugët e territorit të Komunës së Fushë Kosovës</u>	04.08.2020	18.12.2020	KOMUNA E FUSHË KOSOVËS	€ 73,553.80	€ 73,553.80	4 MUJAJ	PO

<u>Numeri i Prokurimit: 6152006121 – Titulli: Pajisje për nxirrje nga energjia solare</u>	21.09.2020	23.12.2020	KOMUNA E PODUJEVËS	€ 37,940.00	€ 37,940.00	3 MUAJ	3 MUAJ
<u>Numeri i Prokurimit: KEO-20-252-121 – Titulli: Furnizim me braking resistors</u>	02.10.2020	27.11.2020	KEK	€ 8,241.12	€ 8,241.12	3 MUAJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: 61520080521 – Titulli: Ndërtimi i ndërrimit publik në dhe tëbuzës</u>	12.10.2020	32.12.2020	KOMUNA E PODUJEVËS	€ 33,003.46	€ 33,003.46	2 MUAJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: KOSTT5320/58-30-32-121 – Titulli: Furnizimi me pjesë rezervë për transformatorë 110kV dhe 35kV</u>	30.09.2020	04.02.2021	KOSTT	€ 15,544.14	€ 15,544.14	3 MUAJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: GBA618-20-6228-5-3-6 – Titulli: Zhvendosja e linjës së transmetimit në afërsi të ndërrimit në rr. administrative</u>	12.11.2020	17.12.2020	KOMUNA E GRACANICES	€ 4,605.80	€ 4,605.80	1 MUAJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: 623-20-063-5-2-1 – Titulli: Rregullimi dhe instalimi i rrymës në dy objektet e Komandës së Rahovecit</u>	10.12.2020	20.12.2020	KOMUNA E RAHOVECIT	€ 9,705.00	€ 9,705.00	1 JAVË	PO
<u>Numeri i prokurimit: 617-20-6878-5-2-1, Titulli: Rregullimi i trotuarve dhe ndërrimit publik në blloqin: Carrarevë, Varrësht e Dëshmorëve në Shtëmë dhe Mollozocë, Parku Teknologjik si dhe ndërrimi i Lirumës</u>	18.11.2020	22.12.2020	KOMUNA E SHITES	€ 64,732.76	€ 64,732.76	12 MUAJ	PO
<u>Numeri i prokurimit: 617-20-7863-5-2-1, Titulli: Rregullimi i ndërrimit publik</u>	15.12.2020	23.12.2020	KOMUNA E SHITES	€ 22,526.00	€ 22,526.00	1 JAVË	PO
GJITHSEJTE TE BEALUJDA PER VITIN 2020				€ 887,286.44			
2021							
<u>Numeri i Prokurimit: KBUM/21/006/021 – Titulli: Furnizimi dhe montimi i shpates metalike me elemente speciale me linjat furnizuese - kabllozbe, 10/20kV</u>	17.03.2021	19.04.2021	KRU MITROVICA	€ 14,164.60	€ 13,909.00	1 MUAJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: 616-21-003-225– Titulli: Mirëmbajtja e ndërrimit publik</u>	08.02.2021	08.08.2021	KOMUNA E PRISHTINËS	€ 8,000.00	€ 8,000.00	6 MUAJ	PO
<u>Numeri i prokurimit: BFO-83/03-2021, Titulli: Furnizim me Isolatör të silikoni 20kV</u>	20.04.2021	28.04.2021	KEDS	€ 46,610.00	€ 46,610.00	1 DITE NGA URDHËRBLERJA	PO

<u>Numeri i Prokurimit: KKO-21-018-121 – Titulli Furnizimi me burgje për abetë</u>	19.04.2021	30.07.2021	KEK	€ 19,824.00	€ 19,824.00	3 Muaj	PO
<u>Numeri i Prokurimit: KKH-21-008-136 – Titulli "Bregullimi i ndërrimit publik në zonën urbane dhe rurale"</u>	10.06.2021	10.07.2021	KOMUNA E HANIT TE ELEZIT	€ 9,751.00	€ 9,751.00	1MUJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: 614-21-015-136 – Titulli Kupa në rritje elektroenergetik për Bistotën e Dytë të Obilje</u>	30.04.2021	23.07.2021	KOMUNA E OBILJIT	€ 2,227.50	€ 2,227.50	1MUJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: 6152107321 – Titulli Ndërrimi publik Lot2 dhe Lot3</u>	26.08.2021	26.11.2021	Komuna e Podujevës	€ 88,434.16	€ 88,434.16	3MUJ	PO
<u>Numeri i prokurimit: 617-21-2850-5-2-1 – Titulli: Bregullimi i infrastrukturës dhe pajisjeve në fshatit Pletërbërës</u>	22.06.2021	22.06.2022	Komuna e Shtimes	€ 27,467.55	€ 15,000.00	12MUJ	Pjesërisht
<u>Numeri i prokurimit: RQ 135/06 2021- Titulli: Furnizim me izolator PSI</u>	23.08.2021	22.09.2021	KEDS	€ 47,200.00	€ 47,200.00	5MUJ	PO
<u>Nr. i Prokurimit: RQ 84/03-2021 – Titulli: Projekti për ndërtimin e rrjetit të distribucionit 2021</u>	17.10.2021	17.03.2022	KEDS	€ 477,861.80	€ 35,000.00	5MUJ	Pjesërisht
<u>Numeri i Prokurimit: 612-21-037-521 – Titulli Vendasja e ndërrimit Publik në rrjetin e Komunes së Fushë Kosovës</u>	13.07.2021	23.11.2021	Komuna e Fushë Kosovës	€ 33,267.80	€ 33,267.80	3MUJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: KOST023/126-21-41-121 – Titulli Furnizim me Bateria 20kV</u>	28.09.2021	30.11.2021	KOSTT	€ 15,340.00	€ 15,340.00	4MUJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: KOST023/126-21-26-136 Titulli Furnizim me Ventilatorë për ftohje e transformatorëve</u>	28.09.2021	05.11.2021	KOSTT	€ 3,624.54	€ 3,624.54	3MUJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: KOST023/126-21-39-121 – Titulli Furnizim me kablo 12/20kV</u>	10.11.2021	24.01.2022	KOSTT	€ 26,211.96	€ 26,211.96	3MUJ	JO
<u>Numeri i Prokurimit: KOST023/126-21-41-121 – Titulli Furnizim me materiale për Ekipin e Mirëmbajtjes së Ndërtuesorëve</u>	10.11.2021	24.01.2022	KOSTT	€ 14,999.92	€ 14,999.92	3MUJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: 11-21-5572-2-3-6 – Titulli: Mirëmbajtja e largërsive 10kV dhe 35kV</u>	22.09.2021	22.09.2022	Iber Lepenci	€ 6,366.00	€ 0.00	12MUJ	JO

<u>Furnizimi dhe montimi i trafostacionit distributiv për nevojë të MPB-Vranidoll</u>	09.11.2021	09.12.2021	ICM	€ 26,840.00	€ 26,840.00	1MUJ	PO
<u>Numeri i Prokurimit: 70050/21/052/216 – Titulli Atesti i rrymës në objektin e Spitalit</u>	09.12.2021	20.12.2022	Spitali Vushtri	€ 1,958.80	€ 1,958.80	1MUJ	PO
<u>Numeri i prokurimit: 21-6-21-001-XXX-OSPIMNOndërrimi i Rrjetit të vlerave furnizues me energji elektrike 10/20kV me elemente periferiale dhe trafot</u>	13.10.2021	04.03.2022	Ministria e Puteve të Brendshme-MPB	€ 123,499.00	€ 123,499.00	3MUJ	PO
<u>Ndërtimi i trafostacionit për ALBA CONSTRUCTION</u>	08.06.2022	04.07.2022	Alba Construction SHPK	€ 41,000.00	€ 41,000.00	1MUJ	PO
GJITHSEJTE REALIZUARA PËR VITIN 2021				€ 572,697.68			

		REKAPITULIM	
2019			€ 614,692.90
2020			€ 887,786.44
2021			€ 572,697.68
TOTALI PËRGJITHSHËM			€ 2,075,176.82

REKAPITULIM
SH.P.K.
RISAJMONI
SHIRINE

Nisur nga dokumentacioni i prezantuar me lart AK është dashur të vlerësoj dokumentet e ofruara te cilat e përmbushin kërkesën sipas DT mbështetur edhe në dispozitat e nenit 59.4 pika (ii), pasi që një gjë e tillë nuk ndikon në substancë dhe nuk përbën ndryshime materiale. Gjithashtu AK është dashur të veproj edhe në bazë të LPP-se ku “Pika 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

Prandaj, bazuar në sqarimin e dhënë, mendoj se pretendimi i OE ankues lidhur me këtë pikë është i BAZUAR.

2 - PRETENDIMI ANKIMOR - Tek arsyja e dytë AK-ja ka dhënë arsyen si në vijim:

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, Certifikatat ISO janë dorëzuar te noteri nga z. Milot Veliu:

1. z. Milot Veliu, i biri i Sami-ut i lindur në Bradash, Podujevë me datë 16.02.1995 (gjashtëmbëdhjetë shkurt një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë), shtetas i Republikës së Kosovës, identitetin e të cilit e kam konstatuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal 1174050364, të lëshuar nga RKS-MPB, madhor me zotësi të plotë veprimi;

Ku personi në fjalë në Ofertën e dorëzuar nga ana juaj nuk ka Autorizim po ashtu nuk është në Listën e Stafit të Kompanisë tuaj, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Arsyetimi i lartcekur i AK-së përveç se është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, i njëjti është edhe tendencioz dhe diskriminues ndaj kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm, për faktin se kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë “Kërkesa 4: Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO

- EN-ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)
- EN-ISO 14001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit)
- BS OHSAS – ISO 45001-2018 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë)”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Dëshmia 4: Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali”.

Pra certifikatat janë kërkuar të noterizuara dhe ne i kemi sjell të njëjtat sipas kërkesës së lartcekur. Në kërkesë askund nuk është specifikuar që noterizimi duhet të bëhet nga ndonjë punëtor i kompanisë apo nga ndonjë person përgjegjës.

Në këtë rast kuptohet qartë se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 56.3 të LPP-së ku përcaktohet qartë se “3.Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Pa marr parasysh faktin se kush e ka bërë noterizimin e ISO certifikatave, përderisa në to figuron emri i kompanisë tonë, atëherë kuptohet qartë fakti se AK-ja na ka eliminuar me arsyetime të pa bazuara dhe të paqëndrueshme.

Nëse eventualisht AK-ja ka pasur ndonjë dyshim/dilemë në lidhje me dokumentet e prezantuara nga ana jonë, atëherë e njëjta ka mundur shumë lehtë të kërkoj sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 9.2 dhe 72 të LPP-së, pra të kërkoj sqarime nga ne apo direk nga noteri, mirëpo që një veprim të tillë nuk e ka bërë.

2 - PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR - Meqenëse si dëshmi dokumentare është kërkuar “Dëshmia 4: Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali”. Në DT nuk specifikohet se noterizimi duhet të bëhet nga ndonjë punëtor i kompanisë apo nga ndonjë person përgjegjës.

Mbështetur në nenin 9.2 dhe 72 të LPP-së AK-ja në raste dyshim/dilemë në lidhje me dokumentet e prezantuara nga OE ankues, është dashur të kërkoj sqarime shtesë edhe pse kjo procedurë nuk paraqet pengesë për të bindur komisionin vlerësues se Certifikatat janë Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali ku kjo punë është përgjegjësi e Noterit e jo e atij që i dërgon për noterizim.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë 1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. 2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. 3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Gjithashtu Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik: Neni 38 Sqarimi i Tenderëve

38.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësisimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, certifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura.

38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, çertifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE.

Ndonëse noterizimi e ISO certifikatave, figuron emri i kompanisë OE ankues, atëherë cili është problemi që AK e ka konsideruar të pa bazuar sepse personi që ka bërë noterizimin nuk është e domosdoshme që me qenë staf i kompanisë.

Prandaj, bazuar në sqarimin e dhënë, mendoj se pretendimi i OE ankues lidhur me këtë pikë është i BAZUAR.

3 - PRETENDIMI ANKIMOR - Pas analizës që i kemi bërë dokumentacioneve të mara, atëherë kemi gjetur këto shkelje të evidentuara nga ana e AK të cilat i kemi evidentuar edhe në kërkesën e parë për rishqyrtim, pra:

OE i renditur me çmim si i treti dhe i propozuar për kontratë OE FAMIS CO ka ofruar çmime jo në harmoni me çmimet e tregut dhe njëkohësisht ka ofruar çmime manipulative.

1. Analizo Ofertën e OE Famis Co, respektivisht paramasa dhe parallogaria, gjegjësisht çmimet e pozicioneve të caktuara, siç janë pozicionet: 17 dhe 24:

17	Furnizim dhe montimi i kablilit të tensionit të mesëm XHE-49-A 1x150/25mm 20kV	m	649.00	15.00	9,735.00
24	Furnizim dhe montimi i kablilit të tensionit të mesëm XHE-49-A 1x240/25mm 20kV	m	585.00	0.80	468.00

Ne paramasë dhe parallogari këto dy pozicione janë identike, respektivisht pozicioni me numër 24 ka seksion me të madh (produkti i kërkuar është i njëjtë me karakteristika elektroteknike identike dhe për nga natyra e aplikueshme për të njëjtin qellim), mirëpo çmimet e pozicioneve kanë dallime substanciale, respektivisht pozicioni me numër 24 ku seksioni i kabllos është me i madh se seksioni i kabllos të pozicionit me numër 17, ndërsa diferenca në çmim është 18.75 here me e lire se pozicioni me numër 17, nga ku shihet se OE i propozuar për kontratë ka ofertuar çmime manipuluese dhe jo-normalisht të ulëta.

Trajtimi jo i barabartë i autoritetit kontraktues vërehet qartë në këtë procedurë vlerësimi sepse në raport me OE ERPOWER & VOLTECH, ka aplikuar dispozitat e Nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët konform LPP, ndërsa të OE i rekomanduar për kontratë, pavarësisht se për pozicionet e njëjta ka çmime ekstrem jo-normalisht të ulëta, nuk ka zbatuar Nenin 61 të LPP-së.

Me këtë rast janë evidentuar shkeljet e bëra nga AK duke mos siguruar një vlerësim dhe trajtim të ofertave konform kërkesave të dosjes së tenderit, respektivisht AK ka nuk ka zbatuar drejtë nenin 59 të LPP-së dhe Nenin 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

3 - PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR -

Sa i përket pretendimit nr.3 do ju referohemi përgjigjes të cilën e ka dhënë AK ndaj kërkesës për rishqyrtim për OE ankues në procedurën e parë si në vijim:

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
Për:	Operatori Ekonomik: "FAMIS CO-HC" SH.A, SUHAREKË - PRIZREN M25 SEMETISHT, 23000, SUHAREKE Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar	
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit	
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës	
Datë:	10.07.2023	

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket Kërkesës për Rishqyrtim të datës: **10.07.2023**, të parashtruar nga **Operatori Ekonomik: "FAMIS CO-HC" SH.A**, me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **ZHVENDOSJA E RRJETIT DHE TRAFOS NË SHESHIN QENDROR**, me Numër të prokurimit: **623-23-5687-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-043-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga **Operatori Ekonomik: "FAMIS CO-HC" SH.A**, me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **ZHVENDOSJA E RRJETIT DHE TRAFOS NË SHESHIN QENDROR**, me Numër të prokurimit: **623-23-5687-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-043-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **04.07.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **ZHVENDOSJA E RRJETIT DHE TRAFOS NË SHESHIN QENDROR**, me Numër të prokurimit: **623-23-5687-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-043-5-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: "FAMIS CO-HC" SH.A, me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **ZHVENDOSJA E RRJETIT DHE TRAFOS NË SHESHIN QENDROR**, me Numër të prokurimit: **623-23-5687-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-043-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **04.07.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **04.07.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIM LANKIMOR Nr. 1:

AK me date 04.07.2023 ka publikuar vendimin ne te cilin specifikohet se eshte rekomanduar per fitues OE: ERPOWER shpk & VOLTECHZ shpk me cmimin prej: 52082.60 euro.
Vlera e parashikuar e ketij projekti eshte: 82,162.50 euro

AK Komuna Rahovec ka shpallur OE fitues me oferten prej: 52,082.60 euro

Oferta jone eshte: 80,002.70 euro.

Ne kemi kerkuar qasje ne dokumentet zyrtare, dhe kemi analizuar oferten e OE te rekomanduar dhe konsiderojme se AK ka bere shkelje te nenit 61 te LPP-se dhe nenit 41 te rregullave te prokurimit publike "Tenderët Jo-normalisht të Ulët".

Te bashkangjitur keni ne detale KERKESEN ne PDF me analizen e cmimeve, dhe cmimet e tregut te cilat ne i posedojme per artikujt e caktuar, e per te cilat AK eshte dashur ta eleminoje OE te rekomanduar e jo ta propozoje per fitues.

OE i rekomanduar ne pozicionet 19,21,22,23 dhe 24 ka ofruar cmime te cilat nuk jane cmime te tregut por jane cmime MANIPULATIVE dhe AK pikerishte per kete qeshtje eshte dashur ta eleminoje OE:

Oferta e OE te rekomanduar ne keto pozicione:

19	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPODO A, 3 kV, 4x70mm	m	98.00	5.00	588.00
20	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPODO A, 3kV, 4x150mm	m	225.00	11.00	2,475.00
21	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPODO A, 3 kV 4*240 mm	m	620.00	5.00	3,100.00
22	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPODO A, 3 kV 4*185 mm	m	350.00	5.00	1,750.00
23	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPODO A, 3 kV 4*185 mm	m	295.00	5.00	1,475.00
24	Furnizimin dhe montimin i kabllit te tensionit te mesmes 20kV-40kV 1x240/25mm 20kV	m	585.00	2.00	1,170.00

Ne perveq ofertes sone e cila ka cmime te tregut, kemi kerkuar edhe nga dy Oe tjere te na sjellin ofertat per te verejtur se keto cmime te ofruara nga Oe i rekomanduar nuk jane te tregut dhe jane cmime manipulative:

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të

Rregullores për Prokurimin Publik, për **Tenderët Jo-normalisht të Ulët**

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, nuk ka përmbushur asnjë Kusht sipas Nenit 11

të Udhëzuesit Nr. 001/2023 Për Prokurimin Publik për Tenderat Jo-Normalisht të Ulët, për tu

konsideruar oferta me **Tenderë Jo-normalisht të Ulët**

Shih tabelarin e bashkangjitur:

Nr.	A	B	C	D
1	Kushti 1: është përmbushur kushti i parë sepse janë pranuar 3 oferta			Pranuar 3 oferta
2		"FAMIS CO-HC" SH.A, SUHAREKË - PRIZREN M25 SEMETISHT, 23000, SUHAREKE	80,002.70	
3		Grup i Operatorëve Ekonomik: ERPOWER SH.P.K; VOLTECHZ SH.P.K., 2 Korriku – VITI	52,082.60	
4		RISAMONT SH.P.K., Kroi I Bardhe, 10 000, Prishtinë	67,412.00	
5		Totali (D7+D8+D9):	199,497.30	
6		Mesatarja (C5/3)	66,499.10	
7	Kushti 2: të gjithë ofertat nën këtë çmim përmbushin kushtin e dytë	Pragu 30% (mesatarja / 1.3)	51,153.15	Ne këtë rast asnjë ofertë nuk përmbushë kushtin e dytë, prandaj vazhdohet me kushtin e tretë
8	Kushti 3: pragu 10 % në mes ofertës me të lirë në krahasim me ofertën e dytë me të lirë	Pragu 10% (oferta e dytë / 1.1)	46,874.34	Ne këtë rast asnjë ofertë nuk përmbushë kushtin e tretë, prandaj vazhdohet me kushtin e tretë

Po ashtu duke u bazuar në pretendim tuaj, se Operatori Ekonomik i rekomanduar për Kontratë ka ofruar çmimet të cilat nuk janë çmimet e tregut por janë çmime MANIPULATIVE dhe AK është dashur të eliminojë OE të rekomanduar e jo të propozojë për fitues.

Ne vazhdim te rekomandimeve tuaja keni cekur se Operatori Ekonomik i rekomanduar per Kontrate ne pozicionet 19, 21, 22, 23 dhe 24 ka ofruar çmimet te cilat nuk jane çmimet e tregut por jane cmime MANIPULATIVE dhe AK është dashur të eleminoje Opretorin Ekononmik, duke pretenduar se keto çmimet, ku keni ofruar dëshmi per keto pozicionet jane çmimet me te shtrenjta ne treg:

DRINII SH.P.K.
Adresa : Zona Industriale, Shiroka n. Ura Dytë e Jari, p.n.
Tel : +38349555085 , Fax :
Nr. Bilesa : 811350701 , Nr. Fiskal : 811350701
ZEPAT BANK KOSOVA, 2200 1301 001113, 55

Profaturë

Niveli : 1/23
Data : 07.07.2023
Afati i Paguesise : 07.07.2023

FAMIS CO - HC SH.A.
NR.UHAK : 810628399
Suharek , Kosovë

Nr.	Shifra	Emertimi	Nj.	Sasia	Çmimi	Çmimi me TVSH	Vlera me TVSH
1	0003	FURIZIM DHE MONTIMI I KABLLUT PP000 A,1KV 4 "240	m	620.00	10.17	12.00	7,440.00
2	0005	FURIZIM DHE MONTIMI I KABLLUT PP000 A,1KV 4 "185	m	350.00	10.00	12.50	4,375.00
3	0005	FURIZIM DHE MONTIMI I KABLLUT PP000 A,1KV 4 "185	m	295.00	10.50	12.50	3,687.50
4	0062	FURIZIMI DHE MONTIMI I KABLLLOS TE TENSIONIT TE MEDEME TE TIPIT XHE 4B-A, 1X30X25 mm2, 25KV	m	585.00	10.17	12.00	7,020.00

Vlerëjtje :

Vlera pa RABAT : 5,949.15
RABAT - I : 0.00
Vlera pa TVSH : 19,086.86
TVSH : 3,425.64
Gjithsej : 22,512.50
Paguesar : 9.90
Borxhi : 22,522.50

"Led Shop Kujta"sh.p.k
Nr.F:811034850 Nr.B:811034850
Nr.TVSH: 330327933
23000 Therande, Republika Kosoves

PRO-FATURA : 000001.
Data: 8/7/2023

Famis CO - HC SH.A
NrU: 810628399, NrT: 330063600, NrB: 810628399

Adresa: SUHAREKE Tel:

ad Shop Kujta"sh.

Nr	Artikulli	Emertimi	Nj.M.	Sasia	Cm. pa TVSH	R(%)	Cm. me TVSH	Vl. pa TVSH	TVSH (%)	TVSH	Vl. me TVSH
1	160915	KAB P000A 1KV 4X240 MM	M	620.00	12.7115	0.00	10.0000	7,881.30	18.00	1,419.64	9,300.94
2	160916	KABELL PPO00A 1 KV 4X185	M	350.00	11.6170	0.00	13.0000	3,855.33	18.00	694.87	4,550.20
3	160917	KABELL 4-1KV 4X185	M	295.00	11.6170	0.00	13.0000	3,269.00	18.00	585.00	3,854.00
4	160918	KABELL 30E-40-A1X240/25MM 25KV	M	585.00	10.1685	0.00	12.0000	5,948.15	18.00	1,070.85	7,019.00

Data e dërgesës: 08-07-2023

Vlera e paguar: 0.00
Vlera per pagese: 24,705.00

Kalkuloi:

Pranoi: _____

OPSIONI I PAGESE ESHTË 5 DITE NGA DATA E PRO-FATURES

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara, ne tabelarin e bashkangjitur i gjeni Krahësimin e çmimeve të ofruara mes Operatori Ekonomik të rekomanduar për Kontrate dhe Ofertës tuaj

				Grup i Operatorëve Ekonomik: ERPOWER SH.P.K; VOLTECHZ SH.P.K., 2 Korriku – VITI		"FAMIS CO-HC" SH.A, SUHAREKË - PRIZREN M25 SEMETISHT, 23000, SUHAREKE	
Nr	Përshkrimi puniemve	Njesia	Sasia	Çmimi me tvsh	Totali	Çmimi me tvsh	Totali
19	Furnizimi dhe montimi I kabllit PPOOO A, 1 kV, 4x70mm	m	98.00	6.00	588.00	9.00	882.00
20	Furnizimi dhe montimi I kabllit PPOOO A, 1kV, 4x150mm	m	225.00	11.00	2,475.00	22.00	4,950.00
21	Furnizimi dhe montimi I kabllit PPOOO A ,1 kV 4*240 mm	m	620.00	5.00	3,100.00	0.60	372.00
22	Furnizimi dhe montimi I kabllit PPOOO A ,1 kV 4*185 mm	m	350.00	5.00	1,750.00	1.00	350.00
23	Furnizimi dhe montimi I kabllit PPOOO A ,1 kV 4*185 mm	m	295.00	5.00	1,475.00	1.00	295.00
24	Furnizim dhe montimi I kabllit të tensionit të mesëm XHE-49-A 1x240/25mm 20kV	m	585.00	2.00	1,170.00	0.80	468.00
				34.00	10,558.00	34.40	7,317.00

Duke u bazuar ne tablearin e bashkangjitur Oferta juaj për keto pozicione është oferta me e lire ne total, andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Pra AK ka rekomanduar për fitues një OE i cili në vende të çmimeve për njësi prej: 12,13,15 EURO, si çmime të tregut ka ofruar çmime manipulative prej: 2, 5,5 dhe 6 EURO !!!.

Edhe Oe tjetër RISAMONT, ka ofruar çmime manipulative, si psh: në pozicionin nr.24 ka ofruar çmimin për njësi prej 8.00 euro, ndërsa nëse i analizojmë dëshmitë e cekura më sipër nr.1 dhe nr.2 çmimi i tregut për këtë artikull është: 12.00 EURO.

24	Furnizim dhe montimi I kabllit të tensionit të mesëm XHE-49-A 1x240/25mm 20kV	m	585.00	8.00	4,680.00
----	--	---	--------	------	----------

5/3

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, se Operatorin Ekonomik RISAMONT ka ofruar çmimet të cilat nuk janë çmimet e tregut por janë çmime MANIPULATIVE, ku për

pozicionin me nr. 24 ka ofertuar me çmimin per njesi prej 8.00 Euro, ndersa nese i analizojme deshmit e cekura me siper nr. 1 dhe nr. 2 çmimi I tregut per kete artikull është: 12.00 Euro.

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara, pasi qe nese i bejme Krahasimin e çmimeve te ofruara mes Operatori Ekonomik RISAMONT dhe Ofertës tuaj, për këtë pozicion është:

				RISAMONT SH.P.K., Kroi I Bardhe, 10 000, Prishtinë		"FAMIS CO-HC" SH.A, SUHAREKË – PRIZSara123REN M25 SEMETISHT, 23000, SUHAREKE	
Nr	Përshkrimi puniemve	Njesia	Sasia	Çmimi me tvsh	Totali	Çmim i me tvsh	Totali
24	Furnizim dhe montimi I kabllit të tensionit të mesëm XHE-49-A 1x240/25mm 20kV	m	585.00	8.00	4,680.00	0.80	468.00

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit

Pra, mbështetur edhe në përgjigjen e AK-së drejtuar OE Famis CO te datës 10.07.2023 shifet se OE i rekomanduar nuk ju ka referu çmimeve te tregut po ka bërë manipulime me çmime siç edhe dhënë përgjigje konkrete në faqen e fundit të përgjigjes nga AK. Po e njëjta situatë është edhe tani e ngritur nga OE ankues RISAMONT shpk për pozicionin me numër 24 ka seksion me të madh (produkti i kërkuar është i njëjtë me karakteristika elektroteknike identike dhe për nga natyra e aplikueshme për të njëjtin qellim), mirëpo çmimet e pozicioneve kanë dallime substanciale, respektivisht pozicioni me numër 24 ku seksioni i kabllor është më i madh se seksioni i kabllor të pozicionit me numër 17, ndërsa diferenca ne çmim është 18.75 herë me e lire se pozicioni me numër rendor 17, nga ku shihet se OE i propozuar për kontratë ka ofertuar çmime manipuluese dhe jo-normalisht të ulëta.

17	Furnizim dhe montimi i kabllit të tensionit të mesëm XHE-49-A 1x150/25mm 20kV	m	649.00	15.00	9,735.00
24	Furnizim dhe montimi i kabllit të tensionit të mesëm XHE-49-A 1x240/25mm 20kV	m	585.00	0.80	468.00

Prandaj, bazuar në sqarimin e dhënë, mendoj se pretendimi i OE ankues lidhur me këtë pikë është i BAZUAR.

4 - PRETENDIMI ANKIMOR -Oferta e OE Famis Co, respektivisht paramasa dhe parallogaria, gjegjësisht çmimet e pozicioneve të caktuara, siç janë pozicionet: 21, 22 dhe 23 janë çmime manipuluese dhe kjo mund të shihet si më poshtë:

19	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPOOO A, 1 kV, 4x70mm	m	98.00	9.00	882.00
20	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPOOO A, 1kV, 4x150mm	m	225.00	22.00	4,950.00
21	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPOOO A, 1 kV 4*240 mm	m	620.00	0.60	372.00
22	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPOOO A, 1 kV 4*185 mm	m	350.00	1.00	350.00
23	Furnizimi dhe montimi i kabllit PPOOO A, 1 kV 4*185 mm	m	295.00	1.00	295.00

Çmimet në këtë pozicione janë çmime manipuluese, pasi që kabllot me seksion me te madh nuk mund të jone NJEZET here me te lira se kabllot me seksion me te vogël, respektivisht edhe pozicioni me numer:19, kablllo PPOO A 1kV, 4x70mm² te jete me çmim NENTE HERE me te larte se kabllot me seksion: PPOO A 1kV, 4x240mm², gjegjësisht seksioni 4x185mm²!

Çmimet e ofertuara për pozicionet e kontestuar janë çmime manipuluese dhe jo-normalisht te ulëta.

OE Famis Co për disa pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht te ulëta e për disa pozicione te caktuara ka ofertuar me çmime tej-normalisht te larta, fakt i cili dëshmon se oferta e OE Famis Co ka çmime manipulative.

4 - PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR -

Çmimet në këtë pozicione janë çmime Jo-Normalisht të Ulët, pasi që kabllot me seksion me te madh nuk mund të jone disa here me të lira se kabllot me seksion me të vogël, respektivisht edhe pozicioni me numer:19, kablllo PPOO A 1kV, 4x70mm² te jetë me çmim NENTE HERE me te larte se kabllot me seksion: PPOO A 1kV, 4x240mm², gjegjësisht seksioni 4x185mm²!

Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët 41.1 Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një

ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës. 41.2 Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulët, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët. 41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme : i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. 41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së. 41.5 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tillë nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

Prandaj, bazuar në sqarimin e dhënë kemi ndryshime drastike të çmimeve në pozicione prandaj pretendimi i OE ankues lidhur me këtë pikë është i BAZUAR.

5 - PRETENDIMI ANKIMOR -OE i rekomanduar për kontratë **nuk** ka plotësuar edhe kërkesën e FDT-së për punë të ngjashme, respektivisht kontratat dhe referenca për punë të ngjashme.

Neni 9.1&9.2 i FDT-së-Kërkesa 3: *Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 124,000.00 €*

Dëshmia 3: Lista e projekteve të kryera, duke plotësuar ANEKSIN 7 të Dosjes së Tenderit, në lëmin e punëve të ngjashme, të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca t ose Certifikata për Kryerjen e Punëve,

Në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca që janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare ose ndërkombëtare, atëherë ato duhet të prezantohen Situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhet me të Njëjtën kontratë – Referencë;

OE i rekomanduar për kontratë Famis Co nuk ka asnjë kontratë apo referencë për punë të ngjashme, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të trajtohet në këtë mënyrë edhe nga Autoriteti Kontraktues.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

5 - PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN ANKIMOR -

Sipas specifikimeve teknike nga AK atëherë Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit

të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 124,000.00 €.

OE i rekomanduar për kontratë siç shifet ne DT nuk ka plotësuar edhe kërkesën e FDT-së për punë të ngjashme, respektivisht kontratat dhe referenca për pune të ngjashme.

Për këto çështje ju kam drejtuar AK-se për të dëshmuar se mbi cilën baze komisioni vlerësues ka bërë verifikimin e këtyre dokumenteve që rrjedhimisht kanë rekomanduar për kontratë OE Famis Co edhe pse është njëri prej 3 operatorëve ekonomik me i shtrenjte.

Bazuar ne Listën e kontratave të cilën e gjeje ne e prokurimi shifet si ne vijim:

ANEKS 7 Lista e kontratave të realizuara ne 3 vitet e fundit

(Duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë)

(Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe të bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër të tillë)

NR.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-mail
1	Ndërtimin e Infrastrukturës në Parkun Industrial në Shirokë,	17.10.2018	15.09.2021	2,393,122.86	Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë	burim.k@gov.net
2	Aneks kontrata Ndërtimin e Infrastrukturës në Parkun Industrial në Shirokë,	02.09.2019	15.09.2021	238,653.16	Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë	burim.k@gov.net
3						
4						
5						
6						

Duke qene se ne ketë liste nga nënshkrim i kontratës deri ne kohen kur është dashur te ofrohen ofertat për projektin ne fjale është me shume se 3 vite prandaj nuk përmbushet kushti sipas DT.

- Ne DT , OE i rekomanduar për kontrate nuk ka kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 124,000.00 €.
- OE i rekomanduar për kontratë siq shifet ne DT nuk ka plotësuar edhe kërkesën e FDT-së për punë të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë,
- OE i rekomanduar për kontratë siq shifet ne DT se nuk ka referenca për pune te ngjashme.

Për te qene me i sigurt ne ketë pike ju kemi drejtuar AK meqenëse ne e prokurimi nuk kam pasur mundësi te siguroje informacionet si ne vijim:

- Kontratat e ngjashme – me dërgoni dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 124,000.00 €.
- Referencat për punët e ngjashme



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: «ProtocolNo»

KËRKESË PËR SQARIME

<i>Kërkesë për sqarime për</i> Contracting Authority	<i>Data e kërkesës</i> 02/08/2023
--	---

Pershkrimi i kërkesës

Pershendetje

Duke qene se jam i autorizuar nga OSHP per trajtimin e lendes OE “RISAMONT SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0533, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku NUK është rekomanduar për kontratë OE “RISAMONT SH.P.K.”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “ZHVENDOSJA E RRJETIT DHE TRAFOS NË SHESHIN QENDROR” me nr. të prokurimit: “623-23-5687-5-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL – RAHOVECË. Meqenese ne e prokurimi nuk kam pasur mundësi te siguroje informacionet si ne vijim prandaj ju lus qe deri nesër me date 03.08.2023 si ne vijim:

- Aneks 7 nga OE i rekomanduar per kontrate te plotësuar, vulosur dhe nënshkruar,
- Kontratat e ngjashme – me dërgoni dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 124,000.00 €.
- Referencat per punët e ngjashme

Ju lutem te me i dërgoni konkretisht këto informata mbi te cilat eshte referuar komisioni vlerësues gjate vlerësimit te ofertave.



Duke qene se kërkesa drejtuar AK-se ka qene me date 02.07.2023 dhe deri me date 07.08.2023 nuk kane kthyer përgjigje edhe pse kemi kërkuar qe te dërgohet informacion ne një afat sa me te shkurtër kohor.

Bazuar ne pretendimet ankimore te OE ankues shifet se OE ankues, bazuar ne dokumentacionin e ofruar dhe hulumtimi i dokumentacionit ne E prokurimi shifet se bazohet ne pretendimet e tij prandaj si rrjedhoje ankesa duhet te merret si e bazuar.

Prandaj, bazuar në sqarimin e dhënë mendoje se pretendimi i OE ankues lidhur me këtë pikë është i BAZUAR

-Mendimi i ekspertit shqyrtues-

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e ekspertit që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të

cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - RISAMONT SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: